



MISIONI PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
Zgjedhjet lokale, Rrethi i dytë, 29 tetor 2017

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale që u mbajtën më 29 tetor ishte konkurrent dhe respektimi i lirive themelore kontribuoi për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Fushata ishte e shkurtër dhe e qetë, me ç'rast partitë garuan për të fituar mbështetje jashtë bazave të tyre tradicionale, edhe pse herë pas here përdorën retorikë agresive. U raportuan raste të izoluara të keqpërdorimit të burimeve administrative dhe të blerjes së votave. Mediat vazhduan të ofrojnë mbulim të balancuar të garuesve, mirëpo kjo u zbeh nga video-klipet negative të fushatës. Dita e zgjedhjeve, në përgjithësi, u menaxhua në mënyrë profesionale, edhe pse puna e anëtarëve të Këshillave zgjedhorë gjatë numërimit të votave ka mundur të përmirësohet.

Korniza ligjore i ofron të drejtat dhe liritë fundamentale dhe në përgjithësi përbën një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Shumica e dispozitave të Kodit zgjedhor (KZ) vlejné edhe për rrethin e dytë, megjithatë KZ-ja nuk i ka të rregulluara në mënyrë të qartë disa aspekte, gjë që e zvogëlon koherencën e kornizës ligjore të zgjedhjeve.

Komisioni shtetëror zgjedhor (KSHZ) e përmirësoi transparencën e punës së tij ndërmjet dy rretheve zgjedhore. Megjithatë, nuk i planifikoi në mënyrë adekuate trajnimet plotësuese, edukimin e votuesve dhe mbështetjen financiare për 10 komuna që kishin llogari të bllokuara. Puna e Komisioneve zgjedhore komunale kryesisht u vlerësua si pozitive, megjithatë, u vërejtë së paku një rast i anshmërisë së perceptuar politike.

Sistemi i ankesave që kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve është i centralizuar. KSHZ-ja i shqyrtoi dhe i refuzoi të gjitha 46 ankesat pas rrethit të parë. Edhe pse nuk u respektua afati ligjor prej 48 orëve, të gjitha rastet u vendosën në mbledhje të hapura dhe vendimet u publikuan onlajn, gjë që kontribuoi për transparencë. Megjithatë, mënyra se si u trajtuan shumë ankesa e rrezikoi sundimin e ligjit dhe rregullsinë e procesit, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së. Gjykata Administrative i mbështeti të gjitha vendimet e KSHZ-së që u apeluan.

Përditësimi i listave të votuesve ndërmjet dy rretheve nuk është i paraparë me ligj, që në fakt ia pamundësoi të drejtën e votës atyre që kanë mbushur 18 vjet ndërmjet dy rretheve zgjedhore. Mbi 900 votues në institucionet ndëshkuese nuk kishin mundësi ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në të dyja rrethet zgjedhore, për shkak nuk kishin dokumente të vlefshme të identifikimit. KSHZ-ja miratoi një vendim, me të cilin votuesve që ishin në listat e votuesve, mirëpo të cilëve u kishte kaluar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim, nuk iu lejua të votonin.

Gjithsej 68 kandidatë nga 8 parti, si dhe 2 kandidatë të pavarur garuan në rrethin e dytë; gjashtë kandidate ishin femra. Fushata u bë dinamike vetëm disa ditë para rrethit të dytë. Strategjitë e fushatave u ridizajnuan, e poashtu u ndryshuan edhe metodat për t'i synuar votuesit e papërcaktuar. Disa parti shprehën shqetësim për shkak të premtimit për mbështetje qeveritare nga kryeministri për komunat që

kanë kryetarë të komunave nga radhët e koalicionit qeveritar. Ky veprim e dëmtoi parimin e ndarjes së shtetit nga partia, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.

Në periudhën para se të mbahet rrethi i dytë, mbulimi i fushatës në lajme ishte i kufizuar, mirëpo u zmadhua në javën e fundit. Në mediat private, reklamimi i paguar u dominua nga dy partitë më të mëdha, kryesisht me ton negativ. Efektiviteti i shqyrtimit gjyqësor të ankesave në lidhje me mediat përpara se të mbahet rrethi i dytë u dëmtua për shkak të tejkalimit të afateve ligjore nga ana e gjykatave.

Dita e zgjedhjeve, në përgjithësi, u menaxhua mirë. Megjithatë, parregullsitë procedurale që u vërejtën gjatë procesit të numërimit të votave e zvogëluan vlerësimin pozitiv, dhe në më shumë se gjysmën e vendvotimeve të vëzhguara, protokollet e rezultateve nuk u paraqitën për këqyrje publike. Nxjerrja e rezultateve u vlerësua si efikase dhe transparente. Në dy komuna u vërejtën tensione jashtë disa vendvotimeve për shkak të prezencës së aktivistëve partiakë; disa raste të presionit mbi votuesit, si dhe disa raste të blerjes së votave iu përcollën organeve kompetente. Pas përfundimit të votimit, koalicioni qeveritar e mirëpriti procesin zgjedhor, ndërsa partia kryesore opozitare deklaroi se nuk do t'i pranojë rezultatet zgjedhore për shkak të shkeljeve të pretenduara në masë të gjerë, para dhe në ditën e zgjedhjeve.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi dhe zhvillimet pas rrethit të parë

Rrethi i parë i zgjedhjeve u mbajt më 15 tetor. Kryetarët e komunave u zgjodhën sipas sistemit të shumicës në dy rrethe zgjedhore, ndërsa këshilltarët u zgjodhën sipas sistemit proporcional me një rreth. Rezultate përfundimtare të rrethit të parë u shpallën nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KSHZ) më 24 tetor, dhe treguan se ka gara të ngushta në një numër të garave për kryetarë të komunave.¹ Dyzet e gjashtë kryetarë komunash u zgjodhën në rrethin e parë. Prej tyre, 38 janë nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), 3 nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), 2 nga Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI), 1 nga Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) dhe 2 kandidatë të pavarur. Nga kryetarët e zgjedhur të komunave, tre ishin gra.² Pas rrethit të parë, në komunat ku zgjedhjet u shpallën të përfunduara, u bë dorëzimi paqësor i pushtetit.

Balotazhet për kryetarë të komunave u caktua të mbahen më 29 tetor në 35 komuna, ku u përfshinë 70 kandidatë, nga të cilët dy të pavarur.³ Prej tyre gjashtë ishin gra. Para balotazhit, Aleanca për Shqiptarët (ASH) shpalli koalicion të ri me Lëvizjen BESA (BESA), ndërsa LSDM-ja e rikonfirmoi mbështetjen e saj për BDI-në.

Ankesat dhe apelimet pas rrethit të parë të zgjedhjeve

Korniza ligjore përcakton një proces të centralizuar për ankesat në lidhje me ditën e zgjedhjeve, me ç'rast KSHZ-ja i shqyrton vetëm rastet që janë parashtruar nga garuesit në zgjedhje sa i përket

¹ Në Shtip, kandidati i partisë Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi (48 për qind), ndërsa kandidati i Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM) (47 për qind); në Kisella Vodë VMRO-DPMNE-ja (45 për qind) ndërsa LSDM-ja (49 për qind); në Gazi Babë, VMRO-DPMNE-ja (44 për qind) ndërsa LSDM-ja (47 për qind).

² Gjithsej, 455 gra janë zgjedhur në këshillat komunalë, që paraqet 33 për qind. Zgjedhjet për këshillat e komunave anëmbanë vendit kryesisht u fituan nga LSDM-ja (41 për qind), VMRO-DPMNE-ja (32 për qind), BDI-ja (10 për qind), pastaj BESA (5 për qind), ASH-ja (5 për qind), Partia Demokratike Shqiptare (1 për qind), PDTM-ja (1 për qind), si dhe partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur (nga 3 për qind).

³ Për të fituar në rrethin e dytë, kandidati thjesht duhet ta fitojë shumicën e votave.

parregullsive në procesin e votimit, numërimin dhe nxjerrjes së rezultateve. Vendimet e KSHZ-së mund të apelojnë në Gjykatën Administrative. Garuesit kanë të drejtë të parashtrijnë ankesa në afat prej 48 orësh nga shpallja e rezultateve preliminare. Megjithatë, KSHZ-ja shpalli një afat të unifikuar, duke mos e konsideruar se kur i ka publikuar rezultatet e veta secili Komision zgjedhor komunal (KZK).⁴ Kjo e shkurtoi dukshëm periudhën kohore për disa ankesa dhe e dëmtoi të drejtën për të pasur mjet efektiv ligjor. Poashtu, dispozitat e rrepta të panevojshme kërkojnë që KSHZ-ja t'i anulojë rezultatet e vendotimeve në rast të parregullsive procedurale, duke i përfshirë edhe parregullsitë e imëta.⁵

KSHZ-ja pranoi 46 ankesa për ditën e zgjedhjeve pas rrethit të parë, me ç'rast pjesa më e madhe e tyre u parashtruan nga koalicioni opozitar. Shumica kishin të bëjnë me parregullsi të imëta, mirëpo në të gjitha kërkohej anulimi i rezultateve të vendotimeve.⁶ KSHZ-ja i refuzoi të gjitha ankesat, me ç'rast anëtarët e saj votuan sipas vijës partiake, që është në kundërshtim me kërkesën për paanshmëri.⁷ Edhe pse shumë raste u shqyrtuan në mënyrë thelbësore, megjithatë ndryshonte përpikëria.⁸ Në disa raste, shkaqet për refuzim ishin të paarsyeshme, ndërsa për disa të tjera kishte mungesë të qartë të bazës së qëndrueshme ligjore.⁹ Disa raste nuk u shqyrtuan për shkaqe teknike, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.¹⁰

Mënyra se si u trajtuan shumë ankesa e rrezikoi sundimin e ligjit dhe rregullsinë e procesit, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.¹¹ Edhe pse nuk u respektua afati kohor prej 48 orësh, KSHZ-ja mori vendim për të gjitha rastet në një mbledhje të hapur dhe ankesat dhe vendimet u publikuan menjëherë në ueb-faqen e KSHZ-së, që kontribuoi për transparencë.

Njëzet e tetë vendime të KSHZ-së u apeluar në Gjykatën Administrative, pothuajse të gjitha brenda afatit prej 24-orësh. Si rregull e përgjithshme, në Gjykatën Administrative nuk mbahen mbledhje publike, që e kufizon transparencën në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore. Megjithatë, gjykata mbajti mbledhje të mbledhje të hapura për të ofruar informata për rastet, siç parasheh KZ-ja; vendimet u morën brenda afatit kohor prej 48-orësh dhe u publikuan menjëherë.¹² Të gjitha ankesat u refuzuan,

⁴ KSHZ-ja caktoi që afati i fundit të jetë në orën 02:00 më 18 tetor, duke u bazuar në supozimin e pasaktë se të gjitha KZK-të i kanë publikuar rezultatet paraprake deri në orën 02:00 më 16 tetor. Postimi i fundit i rezultateve nga KZK-të ishte në orën 22:00 më 17 tetor.

⁵ Shkaqet tjera përfshijnë rastet kur ka më tepër fletëvotime në kutinë e votimit, kur dikush voton në emër të dikujt tjetër dhe kur ndërpritet votimi për më shumë se tre orë.

⁶ Ankesat kishin të bëjnë me rreth 80 vendvotime dhe ndërlihdeshin me zgjedhjet në nëntë komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Shumica pretendonin se votuesve u janë dhënë më tepër fletëvotime ose fletëvotime të gabuara, se ka pasur një numër të vogël të fletëvotimeve të tepërta ose të fletëvotimeve që kanë munguar në kuti, ose kopje të protokolleve që nuk janë plotësuar në tërësi, të panënshkruara ose se ka pasur mospërputhje të numrave.

⁷ Mbledhja u dominua nga katër anëtarë; dy anëtarët e emëruar nga VMRO-DPMNE-ja kërkonin që të miratohen ankesat e partisë së tyre, dy anëtarët e emëruar nga LSDM-ja kërkonin që ato ankesa të refuzohen.

⁸ Në disa raste, KSHZ-ja i thirri anëtarët e komisioneve të niveleve më të ulëta për t'i marrë në pyetje, i kontrolloi materialet zgjedhore dhe bëri rinumërim të votave.

⁹ Shkaqet për refuzim përfshinin mungesën ose prezencën e vërejtjes për parregullsi në protokoll, faktin se KSHZ-ja e ka udhëzuar një KZK, me kërkesë të KZK-së, se si ta zgjidhë një parregullsi të ngjashme, si dhe për shkak se shkeljet nuk kanë qenë të natyrës serioze.

¹⁰ Seksioni II.3.3 (96) i [Kodit për praktika të mira në çështjet zgjedhore \(Kodi për praktika të mira\)](#) i vitit 2002 i Komisionit për demokraci nëpërmjet ligjit (Komisionit të Venedikut) të Këshillit të Evropës thotë se “është e nevojshme të eliminohet formalizmi në mënyrë që të shmangen rastet kur apelimet refuzohen për gabime në hartimin e tyre, veçanërisht për rastet me ndjeshmëri politike”. Për shembull, një ankesë që dëshmonte se ishin ndërruar vendet e numrave të votave të dy partive në sistemin elektornik nuk u mor për shqyrtim dhe gabimi nuk u korrigjua.

¹¹ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) parasheh se “çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”. Shih poashtu paragrafin 18.2 të [Dokumentit të Moskës së OSBE-së të vitit 1991](#).

¹² Vendimet për këto raste u morën nga një grup i gjykatësve të zgjedhur rastësisht. Katër gjykatës ndaj të cilëve është ngritur padi për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar gjatë gjykimit në lidhje me zgjedhjet lokale të vitit 2013, ishin në mesin e gjykatësve të zgjedhur.

duke i lënë rastet e arsyeshme pa mjet efektiv ligjor. Në përgjithësi, afatet për dorëzimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe apelimeve paszgjedhore janë të shkurta pa arsye, që është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare.¹³

Korniza ligjore

Korniza ligjore i ofron të drejtat dhe liritë fundamentale, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe në përgjithësi përbën një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Shumica e dispozitave të Kodit zgjedhor (KZ) vlejné edhe për rrethin e dytë, megjithatë KZ-ja nuk i ka të rregulluara në mënyrë të qartë disa aspekte të procesit, gjë që e zvogëlon koherencën e kornizës ligjore të zgjedhjeve. Kjo përfshin mungesë të dispozitave për të ofruar mundësi për përditësimin e listave të votuesve, për të aplikuar për votim në shtëpi, për ndarjen e bilbordeve dhe hapësirave për posterë dhe për akreditimin e vëzhguesve.

Administrata zgjedhore

Zgjedhjet e rrethit të dytë u administruan nga KSHZ-ja, 35 KZK të vendosura në komunat ku u zhvillua balotazhi dhe 1.517 Këshilla zgjedhorë (KZ). Sekretariati i KSHZ-së i identifikoi KZK-të dhe KZ-të që kishin nevojë për trajnim plotësues për atë se si t'i plotësojnë protokollet e rezultateve.¹⁴ Megjithatë, trajnimet e ofruara nga KSHZ-ja nuk u zbatuan në gjithë vendin dhe ato që u vëzhguan u vlerësuan si të pamjaftueshme nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it. Poashtu, sikurse edhe në rrethin e parë, KSHZ-ja nuk ua qartësoi KZK-ve në mënyrë të detajuar procedurat për përmirësimin e gabimeve në protokolle dhe udhëzimet e saj për komisionet e niveleve më të ulëta nuk ishin sa duhet të qarta.¹⁵ Pozitivisht, gjashtë KZK organizuan trajnime plotësuese me iniciativë të veten për anëtarët e KZ-ve.

Gjatë numërimit të votave në të dyja rrethet, vlefshmëria e fletëvotimeve u përcaktua në bazë të vendimit të KSHZ-së. Në kundërshtim me KZ-në, ky vendim kërkonte nga KZ-të që t'i shpallin të pavlefshme disa fletëvotime në të cilat qëllimi i votuesit ka qenë i qartë.¹⁶ Kjo, së bashku me mungesën e dispozitave për fletëvotimet e dëmtuara pa qëllim dhe për fletëvotimet e zbrazëta, kontribuoi që të ketë një numër të konsiderueshëm të fletëvotimeve të pavlefshme.¹⁷

Shpenzimet për administrimin e zgjedhjeve lokale mbulohen nga pushteti lokal, përveç në rastet kur llogaria e komunës është e bllokuar me vendim gjyqësor. Në rastet e tilla, mjetet financiare ofrohen nga buxheti shtetëror, në bazë të shpenzimeve të zgjedhjeve të mëparshme. Megjithatë, KSHZ-ja nuk i transferoi mjetet në kohë, duke i lënë 10 KZK në vështirësi financiare. Shtatë KZK e informuan MVZ-

¹³ KSHZ-ja i shqyrtoi të gjitha ankesat pazgjedhore në një mbledhje që zgjati 23 orë, dhe nën presion të kohës, dukshëm e shpejtoi shqyrtimin e tyre në pjesën e dytë të mbledhjes. Seksioni Seksioni II.3.3 (95) i Kodit për praktika të mira thotë se "afatet kohore duhet... të zgjasin aq sa të ketë mundësi për apelim, ta garantojnë ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë paraqitjen e apelimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm... Megjithatë, është e lejueshme që t'i jepet pak më shumë kohë (gjykatës më të lartë) për t'i marrë vendimet e saj.

¹⁴ Përbërja e KZ-ve dhe e KZK-ve në pjesën më të madhe mbeti e njëjtë për rrethin e dytë.

¹⁵ Për shembull, rezultatet e gjithë vendit treguan se kishte mospërputhje prej 922 ndërmjet numrit të fletëvotimeve të hedhura dhe numrit të votuesve që kanë votuar në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe mospërputhje prej 310 në zgjedhjet për këshillat komunale.

¹⁶ KZ-ja thekson se fletëvotimi është i vlefshëm nëse numri rendor i kandidatit është i rrethuar ose nëse është shënuar në mënyrë të "padyshimtë". Megjithatë, vendimi i KSHZ-së dhe materialet për trajnim të KZ-ve theksojnë se çdo shenjë që është e ndryshme nga "rrethi i plotë" e bën fletëvotimin të pavlefshëm.

¹⁷ Në rrethin e parë, 4.2 për qind të të gjitha fletëvotimeve të hedhura u shpallën të pavlefshme; në një komunë numri i fletëvotimeve të pavlefshme arriti në tetë për qind; në një duzinë ato ishin mbi pesë për qind. Në shtatë komuna, numri i votave të pavlefshme ishte aq i lartë sa që asnjëri kandidat nuk fitoi 50 për qind të votave të hedhura, me çka u bë e detyrueshme mbajtja e rrethit të dytë.

në e OSBE/ODIHR-it, se i financuan zgjedhjet nga mjetet personale të anëtarëve të tyre.¹⁸

KSHZ-ja e përmirësoi transparencën e saj ndërmjet dy rretheve zgjedhore duke i shpallur paraprakisht mbledhjet dhe agjendat e tyre dhe duke i publikuar onlajn disa vendime të mbledhjeve të fundit. Megjithatë, KSHZ-ja vazhdoi t'i marrë disa vendime në mbledhje të mbyllura.¹⁹ Puna e KSHZ-së kryesisht u vlerësua si pozitive nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, megjithatë, u vërejt së paku një rast i anshmërisë së perceptuar politike para mbajtjes së rrethit të dytë. Numri i video-klipeve për edukimin e votuesve u zmadhua në javën e fundit para zgjedhjeve; megjithatë përpjekjet e gjithëmbarshme të KSHZ-së për të arritur deri te votuesit ishin minimale.

Regjistrimi i votuesve

Nuk ka dispozita ligjore që parashohin përditësim të listave të votuesve ndërmjet dy rretheve zgjedhore, që në fakt ua pamundëson të drejtën e votës atyre që janë hequr nga listat e votuesve për shkak se kanë pasur dokumente identifikimi me afat të kaluar, si dhe atyre që kanë mbushur 18 vjet në atë periudhë, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.²⁰ KSHZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se mbi 900 votues në institucionet ndëshkuese nuk ishin përfshirë në lista për shkak se nuk kishin dokumente të vlefshme të identifikimit dhe ata nuk kishin mundësi të votojnë në asnjërin rreth të votimit. Poashtu, pasi që nuk ka dispozita që u mundësojnë votuesve të votojnë në spitale, në institucionet për përkujdesje afatgjate dhe në shtëpitë e pleqve, këtyre votuesve poashtu iu pamundësua e drejta e votës.

Më 25 tetor, KSHZ-ja e miratoi një vendim me të cilin votuesit që ishin në listat e votuesve, mirëpo të cilëve u kishte kaluar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim ndërmjet dy rretheve zgjedhore, nuk kishin mundësi të votonin.²¹ KSHZ-ja i inkurajoi këta votues që të nxjerrin dokumente të reja para se të mbahet rrethi i dytë.

Ambienti i fushatës dhe financimi i fushatës

Periudha e fushatës zyrtare për rrethin e dytë filloi më 16 tetor dhe përfundoi në mesnatë të datës 27 tetor.²² Në përgjithësi, atmosfera paqësore që u shfaq në rrethin e parë vazhdoi edhe në rrethin e dytë. Garuesit e zhvilluan fushatën lirshëm dhe pa kufizime. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti shumë pretendime për presion mbi votuesit, frikësim dhe blerje të votave nga parti të ndryshme; vetëm disa ishin të besueshme.²³ U parashtruan edhe disa padi penale në Prokurorinë Publike.²⁴

Fushata u bë dinamike vetëm disa ditë para balotazhit. Strategjitë e fushatave u ridizajnuan në nivel

¹⁸ Më 25 tetor, KSHZ-ja vendosi të transferojë 538.000 denarë (përafërsisht 8.500 euro) për t'i mbuluar shpenzimet e transportit për komisionet e niveleve më të ulëta.

¹⁹ Për shembull, më 23 tetor KSHZ-ja vendosi që të mos ketë ndryshime në përbërjen e KZ-ve. Vendimi i njëjtë u votua përsëri në mbledhjen e hapur të mbajtur më 24 tetor.

²⁰ Paragrafi 7.3 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh që Shtetet pjesëmarrëse duhet "ta garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votës për qytetarët e moshës madhore".

²¹ Sipas KZ-së, votuesit duhet të tregojnë letërnjoftim ose pasaportë; nuk përmendet në mënyrë eksplicite vlefshmëria.

²² KZ-ja nuk e rregullon në mënyrë të veçantë fillimin e fushatës në rrethin e dytë, megjithatë supozohet se ajo fillon menjëherë pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë.

²³ Për shembull, në Strugë, u arrestuan dhe u paditën për shitje të votave dhe blerje të votave. Në Kavadar, një person i afërt me një parti u ka bërë presion dy të punësuarve që të sigurojnë 50 vota. Pasi kanë refuzuar, ata janë përjashtuar nga puna. Në Zërnovc, një aktivist i VMRO-DPMNE-së u thirr për t'u marrë në pyetje nga policia në lidhje me veprën penale të shkeljes së të drejtës së votuesve për liri të zgjedhjes. Në Çeshinovë-Obleshevë, tetë anëtarë dhe në Zërnovc pesë anëtarë të VMRO-DPMNE-së u morën në pyetje nga policia, për shkak të denoncimeve për gjoja blerje të votave.

²⁴ Më 29 tetor, KSHZ-ja kuptoi për rastin e ndërtimit të një rruge në Kisella Vodë, që paraqet shkelje të nenit 8a të KZ-së dhe ia përcolli rastin Prokurorisë Publike.

qendror, mirëpo për dallim nga rrethi i parë, kandidatëve iu dha autonomi më e madhe lokale. Në përgjithësi, fushatat u fokusuan në komunikim të drejtpërdrejtë dhe në bashkëbisedim sy më sy me votuesit. Kandidatët vazhduan t'i shfrytëzojnë faqet zyrtare në Facebook për fushatë, megjithatë kjo u bë në nivel më të vogël se sa në rrethin e parë. Disa kandidatë u fokusuan në ato komunitete ku dalja në zgjedhje në rrethin e partë ishte shumë e ulët. Retorika e fushatës ishte më intensive dhe herë pas here agresive në zonat me shqiptarë etnikë, në krahasim me komunat me kandidatë nga LSDM-ja dhe të VMRO-DPMNE-së.²⁵ Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se rrethi i dytë ishte më konkurrent, me ç'rast partitë garonin për të fituar mbështetje jashtë bazës së tyre tradicionale. Kandidatet gra që u takuan me MVZ-në e OSBE/ODIHR-it, nuk shprehën shqetësim sa i përket mungesës për mundësi të barabarta për të zhvilluar fushatë.

Gjatë fushatës për rrethin e dytë, kishe vetëm disa tubime të mëdha ku ishin të pranishme udhëheqësitë më të lartë partiake në nivel shtetëror. Kryeministri, disa herë në kapacitetin e tij zyrtar, iu drejtua elektoratit në tubimet e LSDM-së, dhe e përdori Twitter-in për të dërguar mesazhe të fushatës.²⁶ Ai e promovoi inkluzivitetin, zhvillimin lokal dhe integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Disa parti shprehën shqetësime për premtimet nga ana e kryeministrit për mbështetje qeveritare për komunat që kanë kryetar nga radhët e LSDM-së ose të BDI-së.²⁷ Këto veprime e dëmtuan parimin e ndarjes së shtetit nga partia, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.²⁸

Limiti për shpenzime gjatë fushatës ishte i njëjtë sikurse edhe për rrethin e parë. Nga garuesit kërkohej që të dorëzojnë dy raporte të përkohshme para rrethit të parë, edhe pse nuk kishte sanksione ndaj atyre që nuk i dorëzuan ato në kohë. Raportet e treta të përkohshme për financimin e fushatës duheshin të dorëzohen më 28 tetor, dhe vetëm pesë garues e respektuan këtë kërkesë, që e zvogëloi transparencën e procesit.²⁹ Pas pranimit, shumica e raporteve u publikuan në ueb-faqen e KSHZ-së.

Mediat

Në periudhën para rrethit të dytë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i monitoroi mediat që kryesisht ishin të fokusuar në rezultatet e rrethit të parë me raportim të kufizuar për fushatën e rrethit të dytë.³⁰ Mbulimi në lajme kushtuar garuesve u zmadhua vetëm në javën e fundit të fushatës. Siç parasheh KZ-ja, transmetuesi publik u ofroi kandidatëve hapësirë kohore për emetim pa pagesë në periudhën me shikim më të madh; pesë kandidatë e shfrytëzuan këtë mundësi. Sikurse në rrethin e parë, monitorimi i mediave nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, tregoi se transmetuesi publik i mbuloi të gjithë garuesit në mënyrë të barabartë dhe me ton neutral. Ai i kushtoi, në mes tjerëve, 25 për qind të mbulimit në lajme LSDM-së, 24 për qind VMRO-DPMNE-së, 20 për qind BDI-së, 15 për qind BESË-s dhe 9 për qind ASH-së.

²⁵ Në komunat ku votat e bashkësive më të vogla etnike janë vendimtare, kandidatët i kërkuan votat nga votuesit e këtyre grupeve etnike.

²⁶ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti ngjarje të tilla në Çair, Gazi Babë, Gostivar, Karbinci, Shuto Orizare, Staro Nagoriçan, Strugë dhe Vinicë. Poashtu, më 27 tetor, në llogarinë e tij zyrtare në Twitter, në kapacitet të kryeministrit dhe të liderit të LSDM-së, ai premtoi ulje të çmimit të ujit për 10 për qind për të gjitha amvisëritë në Shtip pas zgjedhjeve.

²⁷ Një numër i shqetësimeve u shprehën nga kandidatët e ASH-së dhe të BESË-s.

²⁸ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh "ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike, në veçanti se partitë politike nuk do të bashkohen me shtetin". Në [Udhëzimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut për parandalimin e dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore](#) parashihet se "që të parandalohet keqpërdorimi i burimeve administrative për ta çekuilibruar terrenin e barabartë gjatë garave zgjedhore, korniza ligjore duhet të theksojë se gjatë fushatës nuk duhet të paraqiten njoftime të rëndësishme që lidhen me ose që kanë për qëllim të krijojnë perceptim të favorshëm ndaj ndonjë partie apo kandidatit."

²⁹ Koalicioni i VMRO-DPMNE-së e informoi KSHZ-në se raportet e saj i ka dërguar me postë.

³⁰ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bëri monitorim të mediave prej 21 shtatorit deri më 15 tetor, dhe prej 16 deri më 29 tetor. Ai përfshinte monitorim sasior dhe cilësor të gjashtë kanaleve televizive: *TVM1, TVM2, Sitel, Kanal 5, Telma, Alsat-M* dhe të katër gazetave të përditshme: *Nova Makedonija, Sloboden Pecat, Veçer* dhe *Koha*.

Kanalet private i kushtuan 40 për qind të mbulimit në lajme LSDM-së, 35 për qind VMRO-DPMNE-së, 9 për qind BDI-së, 9 për qind ASH-së, 4 për qind BESË-s dhe 2 për qind PDSH-së.³¹ Një numër i madh i video-klipeve të paguara reklamuese, me ton negativ, u përdorën kryesisht nga VMRO-DPMNE-ja, dhe herë pas here nga LSDM-ja.

U organizuan debate nga media të ndryshme radiodifuzive ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat e tyre përkatëse. Gjithsej, tetë debate u zhvilluan në kanal publik, TVM1, dhe në kanal privat *Kanal 5*, ndërmjet kandidatëve të LSDM-së dhe atyre të VMRO-DPMNE-së; nuk pati debate ndërmjet kandidatëve etnikë shqiptarë dhe kandidatëve të pavarur.

Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike (ASHAM) inicoi dy procedura kundërvajtëse kundër disa transmetuesve radiodifuzivë gjatë rrethit të dytë. Rastet kishin të bëjnë me shkeljen e dispozitave të KZ-së për limitet e reklamimit të paguar politik dhe raportimin e pabalancuar. Gjykata Themelore mori vendime gjyqësore për dy raste nga rrethi i parë, duke shqiptuar gjopa më të ulëta se sa ato që janë paraparë në KZ. Të dyja vendimet gjyqësore u apeluan nga ASHAM-i, me arsyetimin se gjokat ishin të pamjaftueshme.³² Gjykata akoma nuk ka marrë vendim për këtë apelim. Efektiviteti i shqyrtimit gjyqësor të ankesave në lidhje me mediat para rrethit të dytë u dëmtua për shkak të tejkalimit të afateve ligjore nga ana e gjykatave.

Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

Të gjitha grupet e akredituara të vëzhguesve qytetarë vazhduan me vëzhgimin e aktiviteteve duke përfshirë edhe shpërndarjen e vëzhguesve për balotazhet.³³ Përkundër mungesës së dispozitave ligjore për rrethin e dytë, KSHZ-ja lejoi që organizatat që ishin të akredituara të dorëzojnë lista të reja të vëzhguesve.

Dita e zgjedhjeve

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishin mirë të menaxhuara. Megjithatë, parregullsitë procedurale që u vërejtën gjatë procesit të numërimit të votave e zvogëluan vlerësimin pozitiv. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka njohuri për pesë raste të iniciuara nga policia ndaj votuesve që i kanë fotografuar fletëvotimet e tyre; dy raste të blerjes së votave u përcollën te organet kompetente.³⁴ U vërejt prezencë e fuqishme policore përreth vendvotimeve në disa komuna. Vëzhguesit partiakë dhe ata qytetarë ishin të pranishëm në 92 dhe 54 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, respektivisht. Në 53 për qind të vëzhgimeve, KZ-të ishin të udhëhequra nga gratë, dhe shumica e anëtarëve të KB-ve ishin gra.

Votimi i hershëm më 28 tetor u vlerësua pozitivisht në të gjitha 9 burgjet dhe në 40 nga 44 vëzhgimet e votimit në shtëpi. Vërejtjet negative të vëzhguesve kishin të bëjnë me komprometimin e fshehtësisë së votës dhe me mungesën e kutisë së votimit.

Në ditën e zgjedhjeve, hapja e vendvotimeve u vlerësua pozitivisht në 44 nga 45 vendvotime të vëzhguara. U vërejt një numër shumë i vogël i parregullsive zgjedhore, të cilat nuk ndikuan në integritetin e procesit. Megjithatë, në pesë raste, protokollat nuk ishin plotësuar, dhe në një komunë

³¹ Në përgjithësi, mediat elektronike private që u monitoruan demonstruan një ton mjaft neutral ndaj kandidatëve gjatë mbulimit në lajme.

³² Edhe pse KZ-ja parasheh gjopa prej 8.000 eurosh dhe 4.000 eurosh për këto shkelje, u shqiptuan vetëm dënime prej 4.500 eurosh dhe 2.250 eurosh, respektivisht.

³³ KSHZ-ja akreditoi gjashtë grupe të vëzhguesve qytetarë: MOST, CIVIL, Instituti i Ohrit për strategji ekonomike dhe çështje ndërkombëtare, SINERGIJA, Qendra maqedonase për kulturë dhe zhvillim, Qendra për mirëkuptim dhe bashkëpunim kushtetues.

³⁴ Ministria për Punë të Brendshme pranoi gjithsej 28 raste për shkelje të ndryshme. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejt dy raste të votuesve që i fotografuan fletëvotimet e tyre.

numri i votuesve të regjistruar që ishte shtypur në protokolle nuk ishte i saktë; nga KSHZ-ja u kërkuara korrigjime gabimin.

Votimi u vlerësua pozitivisht në 97 për qind të vëzhgimeve. Megjithatë, në dy komuna u vërejtën tensione jashtë disa vendvotimeve për shkak të prezencës së aktivistëve partiakë.³⁵ Parregullsitë e vërejtura procedurale përfshinin votim familjar (6 për qind), komprometim të fshehtësisë së votës (2 për qind), dhe tejkalim të mandatit nga vëzhguesit partiakë (2 për qind). KSHZ-ja i këshilloi tre KZK si të vepronin në lidhje me parregullsitë e ndryshme.

Vendvotimet u mbyllën në kohë dhe shumica e KZ-ve i ndoqën procedurat për mbylljen e vendvotimeve. Megjithatë, numërimi u vlerësua negativisht në 8 nga 44 rastet e vëzhguara. Në 14 raste, KZ-të nuk e përcaktuan si duhet numrin e votuesve që kanë votuar, dhe në 9 raste nuk i numëruan fletëvotimet e pashfrytëzuara. Më shumë se gjysma e KB-ve të vëzhguara nuk i vendosën publikisht protokollin e rezultateve, gjë që e dëmtoi transparencën.

Nxjerrja e rezultateve ishte efikase dhe transparente në të gjitha 35 KZK-të e vëzhguara. Sistemi i centralizuar për menaxhimin e rezultateve funksionoi në mënyrë të rregullt në gjitha KZK-të, përveç njëjës. Megjithatë, në 16 KZK, u korrigjuan një numër i protokolleve të rezultateve të KB-ve që kishin gabime numerike, që tregojnë se trajnimi për mënyrën se si duhet të plotësohen ato nuk ka qenë i mjaftueshëm. Në gjashtë KZK, u parashtruan ankesa zyrtare.

KSHZ-ja filloi me publikimin onlajn të rezultateve paraprake sipas vendvotimeve një kohë të shkurtër pas mbylljes së votimit. U njoftua se përqindja e daljes në votime ishte 51.92 për qind. Përderisa LSDM-ja dhe BDI-ja e mirëpritën procesin zgjedhor, VMRO-DPMNE-ja deklaroi se nuk do t'i pranojnë rezultatet zgjedhore për shkak të shkeljeve të pretenduara në masë të gjerë, para dhe në ditën e zgjedhjeve.

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 30 tetor 2017 – Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet është rezultat i vëzhgimit nga Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) i shpërndarë nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR). Vlerësimi u bë që të caktohet se a u mbajtën zgjedhjet në përputhje me përkushtimet e OSBE-së, obligimet e tjera ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin shtetëror.

Ambasadori Audrey Glover është shefi i Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, që filloi me punë më 13 shtator.

OSBE/ODIHR-i e ka miratuar Deklaratën e Parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve është dorëzuar para se të përfundojë procesi zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë trajtimin e ankesave dhe apelimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, diku rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Për rrethin e dytë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përfshinte 17 ekspertë në kryeqytet dhe 17 vëzhgues afatgjatë, si dhe 88 vëzhgues afatshkurtë të shpërndarë në mbarë vendin. Në ditën e zgjedhjeve, u shpërndanë 126 vëzhgues, të cilët u siguruan nga 25 vende pjesëmarrëse të OSBE-së.

³⁵ KSHZ-ja pranoi dy ankesa për presion mbi votuesit në vendvotime në Gazi Babë dhe Shuto Orizare. Avokati i popullit pranoi dy ankesa të ngjashme nga një vendvotim në Shtip.

Vëzhguesit dëshirojnë t'i falënderojnë autoritetet e vendit nikoqir për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe Komisionin shtetëror zgjedhor për ndihmën e tij. Ata poashtu dëshirojnë ta shprehin falënderimin e tyre edhe ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadorin Audruy Glover, Shef i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në Shkup, (+389 2 322 2558);
- Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-it, (+48 609 522 266);
- Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (+48 22 5200 680);

Adresa e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

6 Nikolla Kljusev, 1000 Shkup

Tel: +389 2 3222 558, Faksi: +389 2 3226 776

E-mail: office@odihr.org.mk

Ueb-faqja: <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/339261>

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*